



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.

PRISHTINA

Komuna e Shtimes

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" SH.A

04/03/2025

02/236

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

E lidhur në _____ me datë 4/3/2025, ndërmjet :

Komunës së Shtimes, përfaqësuar nga z.Qemajl Aliu, kryetar i Komunës së Shtimes (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe

Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit "Prishtina" Sh.A., rr."Hazir Shala" nr.4, përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Arsim Fetahu (në vazhdim të tekstit: Kompania)

Neni 1 Qëllimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi është hartuar me synimin për të krijuar një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet palëve të përfshira, me qëllimin e përbashkët të financimit dhe realizimit të projektit të specifikuar në këtë dokument. Në këtë kontekst, palët angazhohen të kontribuojnë me burimet e tyre financiare, teknike dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e suksesshëm të këtij projekti, duke ndarë përgjegjësitë dhe përfitimet që rrjedhin nga to.

Qëllimi i lidhjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është financimi i përbashkët i këtij Projekti:

1. Rehabilitimi dhe ndërtimi i ujësjiellësit e kanalizimit në Komunën e Shtimes me vlerë 85,198.00 €. Nga shuma totale e kësaj kontrate që parashikohet të përfundojë brenda vitit 2025, Komuna e Shtimes do të participojë me shumën prej 20,000.00 €, ndërsa KRU Prishtina SH.A. me shumën prej 65,198.00 €.

Neni 2 Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të këtij Memorandumi merr obligim të participojë - bashkefinancojë për projektin e përmendur në nenin 1 të paragrafit 1.
2. Shuma e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, do të ndahet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Shtimes.

Neni 3
Obligimet e Kompanisë

1. Kompania do të hartojë projektin detal dhe i njëjti do të aprovohet nga subjektet e këtij Memorandumi.

Neni 4
Zhvillimi i procedurave të prokurimit

1. Procedurat e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të udhëhiqen nga Kompania KRU "Prishtina" SH.A. e cila do të përzgjedhë Kontraktin, ndërsa në procesin e përzgjedhjes do të jetë një zyrtar nga Komuna.
2. Disbursimi i mjeteve nga të dyja palët e Memorandumit do të realizohen pas pranimit të raportit përfundimtar të punimeve nga Menaxheri i Kontratës.
3. Bartjen e mjeteve Komuna e Shtimes e bën në xhirillogarinë e Kompanisë pasi të përfundojnë procedurat e pranimit teknik dhe raportet përkatëse.

Neni 5
Mbikëqyrja e punimeve

Mbikëqyrja e kontratës do të kryhet nga të dy palët e këtij Memorandumi, ku secili do të caktojë nga një person për mbikëqyrje të punimeve

Neni 6
Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim nga të dy palët.
2. Në rast të çfarëdo paqartësie (kontesti) të këtij Memorandumi të mirëkuptimit, secila palë obligohet të njoftoj palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën me të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Memorandum Mirëkuptimi. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, atëherë pala mund të adresojë çështjen në gjykatën kompetente.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët .
2. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

z. Qemajl Alim
Kryetar i Komunës së Shtimes



z. Asim Fetahu
Kryeshër i Kontratës KRU "Prishtina" sh.a

